

Çka është redundanca?

Redundanca paraqet sinjalet e tepërta në kanalet e komunikimit të cilat nuk janë të nevojshme dhe angazhojnë në mënyrë joracionale kapacitetet e kanalit komunikues.

Çka paraqet redundanca absolute, relative, si llogaritet redundanca si përqindje e sinjaleve të koduara?

Redundanca absolute paraqet diferencën në mes entropisë maksimale dhe sasisë së informatës që përmban porosia e koduar $R = H_{\max} - H_r$; redundanca relative paraqet raportin në mes të redundancës absolute dhe entropisë maksimale, $r = R/H_{\max}$; ndërsa redundanca si përqindje e sinjaleve të koduara jepet me formulën: $r = 1 - I_n/I_m$.

Çka është sistemi informatik?

Sistemi informatik është një bashkësi e elementeve të lidhura të cilat me atributet e tyre mundësojnë përpunimin elektronik të të dhënave.

Cila është komponenta më e rëndësishme e sistemit informatik?

Komponenta më e rëndësishme e sistemit informatik është personeli.

Cilat janë detyrat e sistemit informatik?

Detyrë e sistemit informatik është të mbledhë, të përpunojë, të memorojë dhe të transformojë të dhënat në informata.

Cilat janë vetitë e sistemit informatik?

- **Kompleksiteti** - ka të bëjë jo vetëm me strukturën e elementeve ose komponenteve, por edhe me lidhjet që ka ky system me rrethinën.
- sistemi informatik është **sistem dinamik dhe jostatik** - sepse komponentet e tij me kohë ndërrojnë, prandaj si pasojë mund të ndërrojë edhe vet sistemi.
- sistemi informatik është **sistem artificial** - është krijuar nga njeriu dhe për t'i shërbyer atij për të kryer punë intelektuale.
(sistemi informatik bën mbledhjen dhe koleksionimin ose ndarjen e të dhënave).

Cilat janë profilet e ekspertëve në sistemet informatike?

Profilet e ekspertëve të nevojshëm për punë në sistemet informatike janë: specialistët për software në sistemet informatike, specialistët e komponentës hardware, specialistët e bazave të të dhënave, programerët, analistët sistemor, operatorët etj.

Çka është sistemi informatik i biznesit?

Sistemi informatik i biznesit paraqet një sistem i cili ka për detyrë të sigurojë informata të plota, të sakta, relevante dhe në kohë të cilat duhet të shërbejnë si bazë gjatë procesit të marrjes së vendimeve afariste (struktura menaxheriale).

Përmendi disa nga nënsistemet informative të sistemit informatik të biznesit?

Nënsistemet informative të sistemit informatik të biznesit janë:

- Nënsistemi informatik i blerjes dhe materialit rezervë,



- Nënsistemi informatik i shitjes me shumicë,
- Nënsistemi informatik i shitjes me pakicë,
- Nënsistemi informatik i shitjeve ditore.

Cilat janë llojet e sistemeve informatike?

Llojet e sistemit informatik janë:

- varësisht nga madhësia e inputit dhe outputit ($i = a$, $i > a$, $i < a$)
- sipas vëllimit të të dhënave (sist. inf. të thjeshta dhe të ndërlikuara),
- sipas fushave të përdorimit (sist. informatik i financave, i informatikës, i kontabilitetit, i teknologjisë etj.),
- sipas karakterit (sist. inf. distributive dhe të kombinuara),
- sipas mënyrës së organizimit (sist. inf. të centralizuara dhe të decentralizuara).

Cilat janë fazat e zhvillimit të sistemit informatik të biznesit?

Fazat e zhvillimit të sistemit informatik të biznesit janë: faza iniciale, faza e ekspansionit, faza e konsolidimit, faza e pjekurisë dhe faza e zhdukjes.

Si definohet sistemi informatik i ndërmarrjes?

Sistemi informatik i ndërmarrjes paraqet një ndërlidhje të nënsistemeve informatike elementare në një tërësi unike, strukturale dhe konceptuale, me qëllim të informatizimit të procesit afarist ose shërbyes.


Cilat janë fazat e zhvillimit të sistemit informatik të ndërmarrjes?

Fazat e zhvillimit të sistemit informatik të ndërmarrjes janë: faza iniciale, e ekspansionit, e formalizimit dhe e pjekurisë.

Cila është detyra e sistemit informatik të ndërmarrjes?

Sistemi informatik i ndërmarrjes ka për detyrë ta bëjë sa më të sigurtë rrethinën e ndërmarrjes.

Cilat janë pjesët përbërëse të sistemit informatik të ndërmarrjes?



Cilat janë nënsistemet informatike të ndërmarrjes?

Nënsistemet informatike të ndërmarrjes janë: nënsistemi inf. i prodhimit, i furnizimit me lëndë të parë dhe material rezervë, i financave dhe kontabilitetit, i marketingut, i personelit, procesues.

Çka është karakteristikë e sistemeve informatike nga vitet '90 e këndej?

Karakteristikë është se që nga vitet e '90 e këndej arkitektura e tyre bëhet shumë më funksionale, siç është interneti, rrjetat telekomunikuese për transmetimin e të dhënave në distancë.

Si shpjegoni ndërvarshmërinë mes ndërmarrjes dhe sistemit informatik?

Lidhja e sistemit informatik me ndërmarrjen qëndron në një lidhje reciproke.

Çka është varëshmëria informatike?


Me varëshmëri informative kuptojmë pamundësinë e plotë ose të pjesërishtme të kryerjes së aktiviteteve pa përdorimin e Informatikës.

Si ndikon sistemi informatik në ndërmarrje?

Sistemi informatik ndikon në ndërmarrje duke i ndihmuar asaj që ta kuptojë rrethinën, përkatësisht ndryshimet që ndodhin në rrethinë të përcjell dhe tu pershtatet nëse ka nevojë, dhe në të njëjtën kohë të ndikojë edhe vetë në ndryshimin e rrethinës.

Cilat janë faktorët që ndikojnë në aplikimin e teknologjisë informatike në ndërmarrje?

Në aplikimin e teknologjisë informatike ndikojnë dy faktorë: faktorët e jashtëm (rrethinës) – bëjnë që ndërmarrja ta zhvillojë sistemin informatik dhe faktorët institucional (të brendshëm) – nisën nga nevoja që kërkesat e ndërmarrjes për të pasur një sistem të tillë.



Si ndikon ndërmarrja në sistemet informatike?

Ndërmarrja ndikon në sistemet informatike përmes vendimit se si do të përdorë sistemet informatike dhe cili do të jetë roli i tij në ndërmarrje.

Çka është telekomunikimi?

Me telekomunikim nënkuptojmë të gjitha format e komunikimit ndërnjerëzor në distancë.

Çka paraqesin sistemet telekomunikuese?

Sistemet telekomunikuese paraqesin një koleksion të hardwerit dhe softwerit të cilat janë kompatibil në mes veti dhe mundësojnë transmetimin e informatave nga një lokacion në një lokacion tjetër.

Cilat janë pjesët e sistemit telekomunikues?

Pjesët e sistemit telekomunikues janë: kompjuterët, терминаlet, kanalet komunikuese, softveret, pajisjet tjera ndihmëse.

Çka nënkuptojmë me komunikim satelitor?

Me komunikim satelitor nënkuptojmë bartjen e të gjitha llojeve të sinjaleve tokësore dhe të video sinjaleve përmes sateliteve tokësor në distanca me shpejtësi të madhe.

Çka është telematika?

Me telematikë nënkuptojmë një teknologji të përbashkët e cila paraqet bashkimin e dy teknologjive telekomunikuese dhe informatikës duke krijuar një teknologji të përbashkët.

Çka përfshin telematika?

Telematika përfshin rrjetat kompjuterike, rrjetat e të dhënave, rrjetat për komunikimin e të dhënave dhe rrjetat informative.

Çka kuptojmë me rrjetat kompjuterike?

Me rrjetat kompjuterike kuptojmë ndërlidhjen e dy ose më shumë kompjuterëve në mes veti.

Për çka janë të nevojshme rrjetat kompjuterike?

Rrjetat kompjuterike janë të nevojshme për arsye se lidhin kompjuterët në një lokacion me kompjuterët në lokacionin tjetër, lehtësojnë komunikimin mes shfrytëzuesve të sistemeve të ndryshme, lehtësojnë shpërnadrjen e informatave mes shfrytëzuesve.

Cilat janë fazat e zhvillimit të rrjetave kompjuterike?

Fazat e zhvillimit të rrjetave kompjuterike janë:

1. faza e zhvillimit të përpunimit të kufizuar të të dhënave në distancë,
2. faza e zhvillimit të përpunimit jo të kufizuar të të dhënave në distancë,
3. faza e rrjetave kompjuterike,
4. faza e rrjetave multimediale.

Cilat janë llojet e rrjetave kompjuterike?

Llojet e rrjetave kompjuterike janë:

1. rrjetat në formë të yllit,
2. rrjetat në formë unazore,
3. rrjetat në formë përziera,

Si ndahen rrjetat kompjuterike sipas hapësirës gjeografike?

Rrjetat kompjuterike sipas hapësirës gjeografike ndahen në LAN dhe WAN.

Kur fillon krijimi i rrjetave globale kompjuterike?

Rrjetat globale kompjuterike janë të krijuara në vitet '60 të shek. XX, ndërsa rrjeti i parë është ARPANET që u krijua në vitin 1969.

Çka është interneti?

Interneti është rrjet ndërkombëtar dhe rrjeti më i madh kompjuterik në botë që bën ndërlidhjen e rrjetave kompjuterike të cilët ju mundësojnë kompjuterëve dhe softverteve të instaluar në ta të komunikojnë njëri me tjetrin.

Kur është paraqitur interneti?

Interneti është paraqitur në vitet '80 dhe '90 të shek. XX dhe fillet e tij janë në rrjetat e tjera që ishin nga vitet '60 të shek. XX.

Çka është www dhe kur filloi të përdoret?

WWW është një sistem informatik që jeton në internet, paraqitet si një pako elektronike që mund të përmbajë tekst, fotografi, animacione, video, të organizuara në seksione të quajtura web faqe, dhe filloi të përdoret nga viti 1989.

Çka është intraneti?

Intranet janë rrjetë private të cilat i krijojnë ndërmarrjet në mënyrë që të mundësohet komunikimi mes shfrytëzuesve brenda ndërmarrjes dhe të ju mundësohet në të dhënat që i ka ajo ndërmarrje.

Çka është ekstraneti?

Nëse ndërmarrja ju krijon shfrytëzuesve të jashtëm të qasen në intranet-in e saj atëherë kjo paraqet ekstranetin ose janë intranete private të cilat ju krijojnë qasje shfrytëzuesve të jashtëm.